



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2022, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të “Pozhegu Brothers”, SHPK.
- II. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Parcela kadastrale nr. 00588-18, me sipërfaqe 174 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00588-18, parcela kadastrale, nr. 00588-20, me sipërfaqe 947 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00588-20, parcela kadastrale, nr. 00588-22, me sipërfaqe 213 m² Certifikata e pronësisë P-71914050-00588-22 dhe parcela kadastrale 00588-24, me sipërfaqe 198 m², Certifikata e pronësisë P-71914050-00588-24, Zona kadastrale Matičan, në pronësi të “Pozhegu Brothers”, SHPK, me destinim rrugë, dhe gjelbërim, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme që merret nga ky këmbim është 1532 m².
 2. Kurse prona e paluajtshme që do të jepet në këtë këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale, nr. 00633-1, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00633-1, Zona kadastrale Matičan, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues “Mati 1”, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me Vendimin nr. 01, nr. 35-642, të dt. 01.04.2010.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit në bazë të Planit rregullues “Mati 1”, i miratuar me Vendimin e KK së Prishtinës, nr. 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010, Parcela nr. 633-1, Zona kadastrale Matičan, shtrihet në zonë të planifikuar për rrugë, ndërsa parcelat nr. 588-18, nr. 588-20, nr. 588-22 dhe nr. 588-24, Zona kadastrale Matičan, me destinim gjelbërim dhe rrugë sipas Planit rregullues “Mati 1”, i miratuar me Vendimin e KK së Prishtinës, nr. 01 nr.35-642, dt. 01.04.2010.
- IV. Pas shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.



- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/01-236754/22, më 28.10.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-246903/19/01, dt. 25.03.2021 dhe Vendimit për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Vendimit të kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/03-237331/21, dt. 30.11.2021, ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale, nr.633-1, Zona kadastrale Matiçan, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00633-1, në pronësi të Komunës së Prishtinës me parcelat kadastrale, P-71914050-00588-18, P-71914050-00588-20, P-71914050-00588-22, P-71914050-00588-24, Zona kadastrale Matiçan, në pronësi të “Pozhegu Brothers” SHPK, të cilat gjenden në kuadër të Planit rregullues “Mati 1”, Prishtinë.

Vendimi për inicimin e këmbimit të parcelës së tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit sipas Planit rregullues “Mati 1”, i miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, 01, nr. 35-642, dt. 01.04.2010, parcela nr. 633-1, Zona kadastrale Matiçan, shtrihet në zonë të planifikuar për rrugë, ndërsa parcelat nr. 588-18, nr. 588-20, nr. 588-22 dhe nr. 588-24, Zona kadastrale Matiçan, me destinim gjelbërim dhe rrugë sipas Planit rregullues “Mati 1”, i miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, nr. 01 nr. 35-642, dt. 01.04.2010.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit, nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

